



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Ekstra VII

Shtator

2002

Akte të Papublikuara

Janar 1998-Mars 1998

		Faqe
Vendim i K.M nr.178, datë 6.3.1998	Për caktimin e ekspertëve financiarë të pavarur në kontrollin e regjistrave ose librave të shoqërive huamarrëse.....	3
Vendim i K.M nr.179, datë 6.3.1998	Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.155, datë 4.3.1993 “Për dhënien me qira të objekteve pronë shtetërore dhe privatizimin e objekteve me pronarë trualli”.....	4
Vendim i K.M nr.180, datë 6.3.1998	Për uniformën e Policisë së Burgjeve.....	4

Vendim i K.M nr.182, datë 6.3.1998	Për kalimin e spitalit të burgjeve në varësi të Ministrisë së Drejtësisë.....	5
Vendim i K.M nr.191, datë 20.3.1998	Për përbërjen e Komisionit të Kualifikimit Shkencor.....	6
Vendim i K.M nr.192, datë 2.4.1998	Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohen dhe procedura e shitjes.....	6
Vendim i K.M nr.194, datë 20.3.1998	Për kriteret e përcaktimit të kapitalit themeltar të shoqërive shtetërore që do të krijohen nga shdërrimi i ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare.....	20
Vendim i K.M nr.195, datë 20.3.1998	Për privatizimin e ndërmarrjeve që nuk mund të transformohen.....	21
Vendim i K.M nr.201, datë 26.3.1998	Për kriteret e përdorimit të ardhurave nga shitja dhe qiraja e truallit.....	22
Vendim i K.M nr.202, datë 26.3.1998	Për detyrat e aparatit administrativ të prefekturës.....	23
Vendim i K.M nr.203, datë 26.3.1998	Për nënshkrimin e Kartës Europiane të autonomisë lokale.....	26
Vendim i K.M nr.204, datë 26.3.1998	Për kompetencat, detyrat funksionale dhe financimin e pushtetit lokal	26
Vendim i K.M nr.206, datë 26.3.1998	Për kriteret për pjesëmarrjen e shtetit në përballimin e dëmeve në raste fatkeqësish.....	30

V E N D I M
Nr. 178, datë 6.3.1998

**PËR CAKTIMIN E EKSPERTËVE FINANCIARË TË PAVARUR NË KONTROLLIN E
REGJISTRAVE OSE LIBRAVE TË SHOQËRIVE HUAMARRËSE**

Me propozimin e Zëvendëskryetarit të Këshillit të Ministrave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në mbështetje të ligjit nr. 8215, datë 9.5.1997 “Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, kontrollit financiar do t’i nënshtrohen subjektet e kontrollit, si “Vefa Holding” sh.p.k. “Silva” sh.p.k. “Kamberi” sh.p.k. “Cenaj”sh.p.k. “M.Leka” sh.p.k. të cilat ndodhen në administrim.

2. Si ekspertë financiarë të pavarur në subjektet e kontrollit, të përmendur në pikën 1 të këtij vendimi, caktohen personat sipas listës nr.1 që i bashkëngjitet këtij vendimi.

3. Ekspertët financiarë të pavarur janë me cilësinë e ekspertëve të përkohshëm. Ata e ndërpresin ushtrimin e kompetencave të tyre me vendim të Këshillit të Ministrave.

Nëse ekspertët financiarë largohen nga kjo detyrë, ose kur vendi i tyre mbetet i lirë, në përputhje me ligjin, caktohen ekspertë financiarë nga grupi i mbikëqyrjes, sipas listës nr. 2 që i bashkëngjiten këtij vendimi.

4. Ekspertët financiarë të pavarur kërkojnë nga subjektet e kontrollit dhe administratorët gjithë dokumentacionin e nevojshëm financiar për realizimin e funksioneve të tyre, si regjistrat ose librat e shoqërive, bilancet kontabël, kontratat me kreditorët dhe dokumentet e tjera të shoqërisë, nga periudha e fillimit të veprimtarisë së tyre gjer më sot.

5. Për realizimin e funksioneve të tyre, ekspertët financiarë grumbullojnë nga punonjësit e shoqërive huamarrëse dokumentet dhe informacionet e nevojshme për përmbushjen e detyrës së tyre, si dhe marrin në ruajtje kopjet përkatëse të të gjitha dokumentacioneve financiare.

6. Ekspertët financiarë të pavarur, gjatë kohës që ushtrojnë detyrat e tyre pranë shoqërive huamarrëse, i raportojnë here pas here grupit të mbikëqyrjes për përfundimet e kontrollit dhe zbatimin e dispozitave të ligjit për kontabilitetin, si dhe të standarteve ndërkombëtare në këtë fushë.

7. Punonjësit e shoqërive huamarrëse dhe ata që rezultojnë se kanë dokumente financiare të këtyre shoqërive, pavarësisht se mund t’i kenë ndërprerë marrëdhëniet e punës me këto shoqëri, kur nuk dorëzojnë dokumentacionin financiar dhe pengojnë ekspertët financiarë në përmbushjen e detyrave të tyre, mbajnë përgjegjësi sipas nenit 235 të Kodit Penal.

8. Pagat mujore të ekspertëve financiarë të pavarur janë 35-45 mijë lekë në muaj dhe caktohen nga Grupi i mbikëqyrjes, i cili mban parasysh shtrirjen dhe përmasat e veprimtarisë së shoqërive huamarrëse, numrin e kreditorëve në këto shoqëri etj.

9. Për përballimin e pagave të ekspertëve financiarë të subjekteve të kontrollit, aparatit të Këshillit të Ministrave i shtohen 3.5 milionë lekë në buxhetin e miratuar për vitin 1998.

Ky fond përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr. 179, datë 6.3.1998

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.155, DATË
4.3.1993 “PËR DHËNIEN ME QIRA TË OBJEKTEVE PRONË SHTETËRORE DHE
PRIVATIZIMIN E OBJEKTEVE ME PRONE TRUALLI”**

Me propozimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.155, datë 4.3.1996 “Për dhënien me qira të objekteve pronë shtetërore dhe privatizimi i objekteve me pronar truall”, pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“Objektet sipas pikës 1 të këtij vendimi kur rezultojnë me pronar të truallit, të privatizohen sipas dispozitave në fuqi për privatizimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M Nr.180, datë 6.3.1998

PËR UNIFORMËN E POLICISË SË BURGJEVE

Me propozimin e Ministrisë së Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Policia e burgjeve ka dy uniforma:
 - uniformën ushtarake;
 - uniformën e punës dhe të stërvitjes.
 2. Policia e burgjeve ka emblemën, simbolin dhe shenjën e saj:
 - emblema e policisë së burgjeve është e njëjtë me atë të policisë së rendit dhe vendoset në kapele;
 - simboli i policisë së burgjeve është një beden kalaje me ngjyrë të artë, e rrethuar me gjethe ulliri;
 - shenja e policisë së burgjeve përbëhet nga një çelës, rreth të cilit shkruhet “Policia e Burgjeve” dhe ka ngjyrë të artë.
 3. Uniforma ushtarake e përhershme është :
 - xhaketa ngjyrë blu, e cila në të dy cepat e jakës ka simbolin e policisë së burgjeve dhe në krahun e majtë shenjën e policisë së burgjeve, pantallonat janë në ngjyrën e xhaketës.
 - Kostumi vishet me këmishë me mëngë të gjata në ngjyrë të bardhë dhe kollare ngjyrë blu. Kapelja ka emblemën e policisë dhe një shirit ngjyrë ari. Këpucët gjysma janë me qafa dhe ngjyrë të zezë.
 - Veshja për dimër është xhupi sintetik me veshje të ngrohtë ngjyrë blu me xhup trikoton ngjyrë blu. Xhupi sintetik do të ketë kokore për shi dhe tuta sintetike që vishen me pantallona në kohë shiu, të cilat mbahen në një xhep të veçantë të xhupit.
 4. Uniforma ushtarake për periudhën prill-shtator është me pantallona ngjyrë blu, këmisha me mëngë të shkurtra ngjyrë blu pa kollare dhe kopsa e parë e këmishës e hapur. Nën këmishë vishet një bluzë pambuku me mëngë të shkurtra me ngjyrë të bardhë, si dhe këpucë gjysma me ngjyrë të zezë. Në krahun e majtë të këmishës është stema e policisë së burgjeve.
 5. Uniforma e policisë dhe e stërvitjes është ngjyrë gri me kapele me strehë përpara. Kjo uniformë vishet me këpucë dhe rrip në mes.
 6. Ministri i Drejtësisë miraton normat e furnizimit për veshmbathje për efektivin e Policisë së Burgjeve.
 7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Drejtësisë.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr. 182, datë 6.3.1998

**PËR KALIMIN E SPITALIT TË BURGJEVE NË VARËSI TË MINISTRISË SË
DREJTËSISË**

Me propozimin e Ministrisë së Drejtësisë, mbështetur në ligjin nr.7381, datë 9.5.1990 “Për krijimin e Ministrisë së Drejtësisë”, me shtesën e mëvonshme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Qendra spitalore e të dënuarve kalon nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mjedisit në vartësi të Ministrisë së Drejtësisë me emërtimin “Spitali i burgjeve”, i cili përfshihet në strukturën e Drejtorisë së Përgjithëshme të Burgjeve.

2. Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mjedisit, nga numri i punonjësve të strukturës së ish-qendrës spitalore të të dënuarve të pavionit nr.7, i zbriten gjithsej 34 persona, kurse punonjësit efektivë të kësaj strukture, 32 veta i kalojnë Drejtorisë së Përgjithëshme të Burgjeve.

3. Personeli efektiv të vazhdojë të paguhet me pagat ekzistuese, duke zbatuar indeksimet paralele të sektorit të shëndetësisë deri në rregullimin e posaçëm ligjor.

4. Mjetet kryesore, pajisjet dhe gjendja e medikamenteve i kalojnë Ministrisë së Drejtësisë, duke u dokumentuar sipas rregullave përkatëse.

5. Ministri i Drejtësisë emëron drejtorin dhe miraton rregulloren e brendshme të spitalit të burgjeve.

6. Marrëdhëniet që lidhen me veprimtarinë e spitalit, ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mjedisit rregullohen me udhëzim të përbashkët të titullarëve përkatës.

7. Për kualifikimin profesional, specializimin dhe punën kërkimore-shkencore në spitalin e burgjeve të sigurohet bashkëpunimi i Drejtorisë së Përgjithëshme të Burgjeve me Fakultetin e Mjekësisë të Tiranës.

8. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mjedisit.

9. Aktet nënligjore që bien në kundërshtim me këtë vendim shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr. 191, datë 20.3.1998

PËR PËRBËRJEN E KOMISIONIT TË KUALIFIKIMIT SHKENCOR

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 351, datë 30.6.1993 “Për kualifikimin shkencor dhe klasifikimin e punonjësve pedagogjikë e kërkimorë”, me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Komisioni i Kualifikimit Shkencor përbëhet nga 15 anëtarë:

a) Në detyrën funksionale shtetërore:

1. Ministri i Arsimit dhe Shkencës

2. Kryetari i Akademisë së Shkencave

3. Rektori i Universitetit të Tiranës

4. Rektori i Universitetit Bujqësor

5. Rektori i Universitetit të Shkodrës
 6. Rektori i Akademisë së Arteve të Bukura
 - b) Me titull personal:
 1. Prof. Dr. Selam Muço
 2. Prof. Dr. Dhimitër Haxhimihali
 3. Prof. Dr. Sabah Ilmia
 4. Prof. Dr. Luan Omari
 5. Prof. Dr. Sihasi Koçiu
 6. Prof. Dr. Ethem Lika
 7. Prof. Dr. Spiro Dedja
 8. Prof. Dr. Floresha Dado
 9. Prof. Dr. Muzafer Korkuti
 2. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 562, datë 5.8.1996 “Për përbërjen e Komisionit të Kualifikimit Shkencor” shfuqizohet.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr. 192, datë 2.4.1998

**PËR KRITERET E VLERËSIMIT TË PRONËS SHETETËRORE QË PRIVATIZOHEN DHE
PROCEDURA E SHITJES**

Në zbatim të ligjit nr. 7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe të privatizimit”, ndryshuar me ligjin nr. 8159, datë 7.11.1996, me qëllim që të përmirësohen procedurat e vlerësimit të ndërmarrjeve të vogla e të mesme, të cilat do të privatizohen, me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Agjencisë Kombëtare të Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

I. Vlerësimi i elementeve të pasurisë dhe kompetencat:

Vlera aktuale minimale (VAM) për çdo element të pasurisë shtetërore llogaritet duke korrigjuar vlerën kontabël të mbetur me koeficientin e indeksit mujor dhe vendodhjen sipas pasqyrës së bashkëlidhur.

1. Për ndërtesat dhe ndërtimet që figurojnë si njësi të veçanta të ndërmarrjes, vlera kontabël e mbetur të përcaktohet duke zbritur nga vlera kontabël (fillestare) shumë e amortizimit të llogaritur në bazë të viteve të qenies në përdorim dhe normës vjetore të konsumit, që përcatohet sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 401, datë 23.10.1989, pjesa “Amortizimi për investimet”.

Për ndërtesat dhe ndërtimet, pas vitit të liberalizimit të çmimeve (korrik 1992), vlera aktuale minimale do të llogaritet sipas kapitullit I dhe mbi të do të zbatohet koeficienti i indeksit të çmimeve, që del nga raporti ndërmjet dy koeficientëve (të periudhës së vlerësimit ndaj asaj të ndërtimit, ose të vënies në shfrytëzim).

Për rastet që cilësohen më poshtë, përcaktimi i vlerës aktuale minimale bëhet nga grupi i ekspertëve vlerësues, të cilët kërkohen nga komisioni i vlerësimit dhe miratohen nga organi qendror ose i pushtetit lokal, sipas vartësisë administrative të ndërmarrjes:

- Vlera aktuale minimale që del nga llogaritja e mësipërme, duket jobindëse, atëherë ekspertët vlerësues bëjnë një vlerësim të ri. Në këtë rast zgjidhet vlera aktuale minimale që duket më e përafërt ndaj gjendjes reale të objektit.

- Mungojnë të dhënat për: a) vjetërsinë e objektit, b) vlerën kontabël bruto, c) objektin e veçuar nga një tërësi me të dhënat e njohura. Në këtë rast grupi i ekspertëve vlerësues përcakton

vlerën kontabël të mbetur, duke përdorur çmime të manualit 1986-1990, dhe zbaton koeficientin e indeksit mujor dhe koeficientin e vendndodhjes.

- Kur mungon vitit i vënies në shfrytëzim, grupi i ekspertëve vlerësues gjykon vetë për amortizimin. Mbi vlerën kontabël të mbetur zbatohet koeficienti i indeksit mujor, si dhe koeficientin e vendndodhjes.

- Objekti ka dëmtime fizike, ose mungesa pjesësh a instalimesh organike, që cenojnë funksionimin e tij. Vlera kontabël e mbetur llogaritet mbi bazën e diferencës së vlerës fillestare të objektit me vlerën fillestare të mungesave ose të dëmtimeve, që përcaktohen nga grupi i ekspertëve vlerësues. Mbi këtë vlerë zbatohet koeficienti i indeksit mujor, si dhe koeficienti i vendndodhjes.

Për të gjitha rastet e mësipërme ekspertët vlerësues, mbi bazën e dokumentacionit teknik përkatës, përgatitin raportin e vlerësimit, i cili duhet të miratohet nga komisioni i vlerësimit.

Dokumentacioni teknik i ekspertëve vlerësues, raporti i tyre dhe miratimi i komisionit të vlerësimit përfshihet në dosjen e vlerësimit.

2. Për ndërtimet në proces vlera aktuale minimale përcaktohet nga kapitulli I.

- Vlera fillestare llogaritet në bazë të situacioneve të papranuara për likuidim nga banka.

- Për ndërtimet në proces, pas korrikut 1992 e në vazhdim, vlera e punimeve, për çdo situacion të dorëzuar në bankë, do të korrigjohet: a) me raportin e koeficientit të indeksit të çmimit të periudhës së vlerësimit ndaj atij të përfundimit të indeksit të çmimit të periudhës së vlerësimit ndaj atij të përfundimit të punimeve dhe b) me shtesa ose pakësimet për vendndodhjen.

3. Për makineritë dhe pajisjet vlera aktuale minimale përcaktohet në bazë të vlerës kontabël të mbetur, e korrigjuar me koeficientin e indeksit mujor.

Vlera kontabël e mbetur përcaktohet për çdo makineri ose pajisje që përbën njësi inventari të veçantë.

Për makineritë dhe pajisjet e prodhuara, ose të blera pas vitit të liberalizimit të çmimeve (korrik 1992), vlera aktuale minimale do të përcaktohet njëjloj si për ndërtimet, por pa zbatuar shtesat a pakësimet për vendndodhjen. Vlera aktuale minimale do të përcaktohet nga grupi i ekspertëve për rastet që vijojnë:

- kur vlera minimale e përcaktuar në bazë të të dhënave kontabël gjykohet se nuk i përgjigjet gjendjes reale të makinerisë a pajisjes së dhënë;

- kur të dhënat kontabël në ndërmarrje mungojnë ose nuk janë të rregullta;

- kur makinerive a pajisjeve u mungojnë pjesë ose nyja që cenojnë funksionimin, ose kanë dëmtime që duhen ndrequr.

Për këto raste grupi i ekspertëve përpilon raportin e vlerësimit dhe vepron njëjloj si grupi i ekspertëve për ndërtimet, por pa zbatuar koeficientin e vendndodhjes.

4. Për mjetet dhe mekanizmat e transportit tokësor e detar të blera para korrikut 1992 dhe për ato që aktualisht nuk kanë çmime të tregut të lirë, sepse nuk importohen më, vlera aktuale minimale përcaktohen në bazë të vlerës kontabël të mbetur dhe të koeficientit të indeksit mujor. Për mjetet dhe makineritë e transportit të blera gjatë vitit 1992 e në vazhdim, VAM-i llogaritet duke u nisur nga çmimi i blerjes minus shumën e amortizimit për vitet e përdorimit pas blerjes.

5. Për inventarin ekonomik, instrumentet dhe veglat e punës, si dhe elemente të tjera që figurojnë në përbërje të aktiveve të qëndrueshme (mjete kryesore) të ndërmarrjes, vlera aktuale minimale përcaktohet nga komisioni i vlerësimit, në bazë të vlerës kontabël të mbetur. Vlera kontabël e mbetur përcaktohet për çdo njësi inventari, duke zbritur nga vlera shumë e amortizimit që i përgjigjet shkallës së konsumit për shkak të përdorimit, duke zbatuar edhe indeksin mujor.

6. Për kafshët e punës e të përdorimit të prodhimit dhe për gjënë e gjallë në rritje e majmëri, vlera aktuale minimale përcaktohet nga komisioni i vlerësimit, në bazë të çmimeve të tregut, duke pasur parasysh, vlerën zooteknike.

7. Për kulturat drufrutore, ullinjë, vreshtat në prodhim ose në rritje vlera aktuale minimale përcaktohet nga komisioni i vlerësimit, në bazë të llogaritjes së vlerës kontabël të regjistruar dhe duke zbritur, kur është rasti, amortizimet e pësura.

Për rastet e mungesave ose të dëmtimeve, komisioni a grupi i ekspertëve të veprojnë si në rastin për ndërtimet. Për këtë grup vlera e mbetur nuk indeksohet.

8. Vlerësimi i mjeteve të xhiros që janë gjendje në ndërmarrje, bëhet në këtë mënyrë:

Komisioni i vlerësimit i ndan mjetet e xhiros në tri grupe:

- a) në artikuj që kanë vlera tregtimi me qarkullim normal;

b) në artikuj që kanë vlera tregtimi me qarkullim të ngadalshëm;
d) artikujt që nuk gjejnë treg shitjeje dhe nuk kanë vlerë aktuale si materiale e pjesë ndërrimi që përdoren nga makineri e mjete transporti të hequra nga përdorimi.

Artikujt e grupit “a” vlerësohen me vlerën aktuale kontabël, duke i krahasuar me çmimet e shitjes me shumicë në tregun aktual.

Artikujt e grupit “b” vlerësohen me vlerën kontabël të kohës së blerjes së artikullit, ose përgatitjes së produktit të gatshëm për shitje, duke i krahasuar me çmimet e shitjes me shumicë në tregun aktual.

Artikujt e grupit “c” vlerësohen me vlerën kontabël të kohës kur janë futur gjendje në ndërmarrje, të shumëzuar me koeficientin 0.1.

Kur ka elementë pasurie pa vlerë përdorimi a të zhvlerësuar, nxirren jashtë përdorimit ose u ulen vlera.

Nxjerrja jashtë përdorimit bëhet në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.170, datë 3.4.1993.

Ulja e vlerës bëhet nga komisioni i vlerësimit dhe me pjesëmarrjen e grupit të ekspertëve të fushave përkatëse, në varësi nga natyra e elementëve të pasurisë dhe miratohet nga këshilli drejtues i ndërmarrjes.

Vlera e nxjerrë nga komisioni i vlerësimit ditën e mbylljes së vlerësimit, si pasojë e shumës së tri vlerave të sipërpërmendura, do të përfaqësojë vlerën aktuale minimale të mjeteve të xhiros në momentin e shitjes për ndërmarrjet me veprimtari të bllokuar në intervalin e kohës vlerësim- shitje.

Për ndërmarrjet që vazhdojnë veprimtaritë gjatë intervalit vlerësim-shitje, blerjet pas vlerësimit të pasqyrohen në kartela të reja, kurse shitjet në kartelat ekzistuese. Në këtë rast, i jepet e drejta likuidatorit që për artikujt e rinj të grupit “a” me grup ekspertësh të bëjë vlerësimin e tyre sipas çmimeve aktuale të tregut me shumicë.

Për të tjerët qëndron në fuqi mënyra e sipërpërmendur e vlerësimit.

9. Vlerësimi i detyrimeve të ndihmave shtetërore që krijojnë fond kundërparti, të bëhet sipas kriterëve të vendimeve të Këshillit të Ministrave nr. 465, datë 3.10.1994, dhe nr. 55, datë 30.1.1995, dhe udhëzimit të Ministrisë së Financave në zbatim të tyre. Këto do të pasqyrohen si zë më vete, pasi pagesa e tyre do të bëhet në lekë.

10. Dokumentacioni për vlerësimin e pronës shtetërore që privatizohet do të përgatitet sipas pasqyrave që i bashkëngjitet këtij vendimi.

II. Detyrimet debitore dhe kreditore:

Detyrimet debitore dhe kreditore të ndërmarrjeve shtetërore që privatizohen, mbyllen në momentin e ndryshimit të pronësisë. Drejtori i ndërmarrjes shtetërore mban përgjegjësi për rritjen debi-kredive nga data e shpalljes së ndryshimit të pronë shtetërore.

Për detyrimet debitore dhe kreditore vepohet si vijon:

1. Kur bëhet privatizimi i gjithë ndërmarrjes shtetërore, detyrimet debitore dhe kreditore i kalojnë shtetit. Organi qendror ose pushteti lokal, sipas vartësisë administrative të ndërmarrjes, ngarkojnë një punonjës të sistemit financiar, ose një profesionist të lirë, me një kontratë të posaçme për ndjekjen e arkëtimit, deri në 30 ditë nga data e dorëzimit të objektit. Këta kanë të drejtën e shpërblimit nga 5 deri në 10 për qind të shumave të arkëtuara, por jo më shumë se 12 paga bazë të përgjegjësit të financës në këshillin e rrethit ose bashkisë. Ky shpërblim reduktohet deri në zero, në qoftë se nuk zbatohet kontrata. Kjo të jetë e vlefshme deri në tre muaj dhe pas kësaj vepohet në bazë të ligjit nr. 8017, datë 25.10.1995 “Për procedurat e falimentimit”.

2. Kur bëhet privatizimi i pjesshëm i ndërmarrjes shtetërore, detyrimet debitore dhe kreditore të ndërmarrjes i kalojnë për ndjekje administratës për pjesën që mbetet shtetërore.

3. Likuidimi i detyrimeve të mbetura, për fondin kundërparti të ndihmave shtetërore, bëhet sipas kriterëve të vendimeve të Këshillit të Ministrave nr. 465, datë 3.10.1994, nr. 55, datë 30.1.1995, si dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave të nxjerra në zbatim të tyre.

III. Procedurat e shitjes së pronës shtetërore:

1. Në këtë vendim, pronë shtetërore konsiderohet çdo njësi prodhimi, shërbimi, pjesë e tyre, mjete lundrimi e mjete xhiroje që janë vendosur të shiten si pasuri fizike, sipas përcaktimit të bërë nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

2. Privatizimi i këtyre objekteve do të bëhet nëpërmjet ankandit.

a) Ish-pronarët e truallit, në zbatim të ligjit "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve", kanë të drejtën e parablerjes, por gjithmonë sipas çmimeve të tregut të përcaktuar në ankand. Vlera e truallit do të kompensohet në përputhje me dispozitat në fuqi.

3. Për punonjësit që i kanë në përdorim automjetet, makineritë, pajisjet dhe mjetet e punës, të cilat janë të panevojshme për zhvillimin e veprimtarisë dhe propozohen të shiten të shkëputura nga objektet, kryhet shitja pa ankand. Miratimi për shitjen e tyre bëhet nga organi që ka në vartësi administrative ndërmarrjen. Në rast se punonjësit që i kanë në përdorim nuk bëjnë kërkesë për blerjen e tyre brenda afatit të publikuar, objektet kalojnë në ankand.

4. Procedurat e publikimit fillojnë pasi të jenë dorëzuar në AKP ose në degën e AKP-së dokumentet e vlerësimit të objektit. AKP-ja ose dega e AKP-së e pranon dosjen e objektit, nëse ekziston dokument i rregullt se ka kaluar në strukturat përkatëse të Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit. Në të kundërtën, kërkohet plotësimi i dokumentacionit.

Vlera e fillimit të ankandit do të jetë VAM-i i përcaktuar sipas kapitullit të parë të këtij vendimi (mjete kryesore+mjete xhiroje). Ankandi do të zhvillohet vetëm për mjetet kryesore dhe vlera e mjeteve të xhiros do të shtohet sipas inventarit fizik në momentin e dorëzimit të objektit.

Agjencia Kombëtare e Privatizimit dhe degët e AKP-së në rrethe, me të pranuar dokumentet e vlerësimit të objektit, fillon publikimin për privatizim:

a) Vendoset një njoftim në tri gazeta me qarkullim kombëtar, të paktën katër herë në dy javët e para.

b) Periudha e publikimit duhet të jetë 21 ditë nga njoftimi i parë.

c) Në fillimin e publikimit, AKP-ja dhe degët e saj duhet të vendosin njoftimin me afishe në mjediset e tyre për objektet që do të privatizohen.

Njoftimi për publikim duhet të përcaktojë informacionin vijues:

- vendin, datën dhe orën e zhvillimit të ankandit;
- emërtimin dhe vendodhjen e objektit që do të privatizohet;
- vlefthën fillestare të fillimit të ankandit;
- sipërfaqen e objektit;
- të dhënat për veprimtarinë e kryer.

Pjesëmarrësit në ankand, pas regjistrimit të kërkesës së tyre në AKP, kanë të drejtë të studiojnë dokumentacionin e vlerësimit që ndodhet i depozituar në AKP.

5. Agjencia Kombëtare e Privatizimit dhe degët e saj në rrethe hartojnë dhe arkivojnë një procesverbal që përmban: emrin e gazetës, datat kur janë botuar njoftimet, si dhe një kopje të njoftimit me afishe.

6. Pjesëmarrësit në ankand duhet të paraqesin në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit këtë dokumentacion:

a) kërkesë me shkrim për blerjen e objektit;

b) mandatin ose garanci bankare që vërteton pagesën 20 për qind të vlefthës së fillimit të ankandit në lekë, e cila paguhet në llogarinë përkatëse të AKP-së detyrimisht brenda afatit të pranimit të kërkesave.

7. Ish-pronari i tokës, bashkëngjitur kërkesës për blerjen e ndërmarrjes ose objektit, që shtrihet mbi tokën ish-pronë e tij, duhet të paraqesë në AKP ose në degën e saj, përveç sa kërkohet në pikën 6, edhe vendimin përkatës të komisionit të kthimit dhe kompensimit të pronave ish-pronarëve, që përcakton se ai është ish-pronar i tokës.

Kur sipërfaqja e tokës ish-pronë private shtrihet mbi 80 për qind të gjithë tokës nën objekt, e drejta e parablerjes shtrihet në gjithë objektin. Kjo është për rastet edhe kur ka disa bashkëpronarë e ndërmjet tyre ka një marrëveshje të dokumentuar.

Në rastet kur objektit i është ulur vleftha e fillimit të ankandit (meqë nuk është shitur me çmim fillestar të publikuar), ish-pronari, për të gëzuar të drejtën e parablerjes, duhet të bëjë pagesën e plotë sipas vlefthës fillestare dhe jo sipas vlefthës së ulur.

8. Kur për objektet e shpallura për shitje, sipas procedurave të këtij vendimi, nuk paraqitet asnjë kërkesë për blerjen e tyre, atëherë Agjencia Kombëtare e Privatizimit dhe degët e saj në rrethe caktojnë një VAM tjetër më të ulët që josh kandidatët për privatizimin e objektit. Ulja e VAM-it të objekteve të bëhet sipas këtij kategorizimi të rretheve dhe vetëm për mjetet kryesore:

- Për rrethet e kategorisë së I-rë: Tirana, Durrësi, Fieri, Korça, Lushnja, Saranda, Shkodra,

Elbasani, Vlora, Kavaja dhe Lezha deri në 30 për qind.

- Për rrethet e kategorisë së II-të: Gjirokastra, Pogradeci, Berati, Kruja, Kurbini dhe Devolli deri në 50 për qind.

- Për rrethet e kategorisë së III-të: Kolonja, Mallakastra, Librazhdi, Peqini, Tepelena, Malësi e Madhe, Peshkopi, Kukësi, Përmeti, Bulqiza, Mati, Gramshi, Hasi, Kuçova, Puka, Skrapar, Tropoja dhe Delvina deri në 70 për qind.

Në këto raste objekti kalon edhe një herë në të gjitha procedurat e këtij vendimi.

Për rastet kur blerësi mbetet vetëm një, bëhet për 10 ditë një njoftim i ri në gazetën nacionale dhe vendoset një njoftim me afishe pranë mjediseve të AKP-së ose degëve të saj në rrethe. Nëse edhe pas këtij njoftimi nuk paraqitet ndonjë kandidat për blerjen e objektit, atëherë dega e Agjencisë Kombëtare të Privatizimit bën shitjen e objektit.

9. Për objektet që mbeten pa u shitur dhe pasi është vepruar sipas pikës 8, atëherë do të vepohet sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 197, datë 20.3.1998 "Për nxjerrjen jashtë shpërdorimit të objekteve që nuk kanë qenë e mundur të shiten".

10. Kur ankandi zhvillohet nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit, komisioni i ankandit përbëhet nga këto persona:

Përfaqësuesi i AKP-së	kryetar
Përfaqësuesi i Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit	anëtar
Përfaqësuesi i organit që ka në administrim objektin	anëtar

Për ankandet që zhvillohen në degët e AKP-së në rrethe, anëtarë të komisionit të ankandit janë:

Përfaqësuesi i degës së AKP-së	kryetar
Përfaqësuesi i Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit	anëtar
Përfaqësuesi i organit që ka në administrim objektin	anëtar

Është e detyrueshme pjesëmarrja e komisionit të ankandit në datën dhe orën e caktuar për ankand.

Komisioni i ankandit ka këto detyra:

-Të regjistrojë dhe vërtetojë identitetin e pjesëmarrësve në ankand sipas letërnjoftimit ose certifikatës së gjendjes civile, ose me prokurë të veçantë përfaqësimi.

-Të prezantojë anëtarët e komisionit të ankandit.

-Të deklarojë vlefshëm fillestare të ankandit.

-Të drejtojë marrjen e ofertave.

-Të shpallë personin e fundit që deklaron çmimin më të lartë si fitues i ankandit.

- Të sigurojë që dhënia e ofertave të vazhdojë deri sa të ketë oferta të tjera përpara shpalljes së fituesit. Organizuesi i ankandit është i detyruar të deklarojë fituesin e ankandit.

11. Fituesi i ankandit të ndërmarrjes ose objektit shpallet ai pjesëmarrës që ofron çmimin më të lartë.

Pjesëmarrësve të tjerë (përveç fituesit) i kthehet 20 për qind e vlefshëm fillestare të paguar paraprakisht.

12. Personi që ka fituar të drejtën e blerjes së objektit nëpërmjet ankandit ose me të drejtën e parablerjes nga ana e AKP-së apo dega e saj pajiset me autorizim për kalim pronësie. Në këtë autorizim duhet të jenë përcaktuar qartë detyrimet e blerësit.

13. Nëse personi që ka fituar të drejtën e blerjes së objektit nuk paguan brenda 30 ditëve vlefshëm e plotë nga dita e paraqitjes si pronar token apo fitues ankandi, ai humbet të drejtën e blerjes. Objekti rishpallet për shitje, duke zbatuar procedurat e publikimit nga e para.

14. Blerësi është i detyruar të bëjë pagesën e pjesës së mbetur 100 për qind në lekë, kur 20 për qind e vlefshëm fillestare të objektit, është paguar në lekë. Nga pagesa 20 për qind e vlefshëm së paguar në lekë, 5 për qind mbahen si e ardhur e AKP-së.

15. Pas pagesës të vlefshëm së plotë të objektit, AKP-ja dhe degët e saj në rrethe janë të detyruara të lidhin kontratën e shitjes nga pala shitëse (përfaqësuesi i AKP-së për dorëzimin e pronës, drejtori i ndërmarrjes, blerësi privat dhe AKP-ja).

Nënshkrimi i kontratës nga përfaqësuesit e shtetit dhe dorëzimi i objektit nga përfaqësuesi i AKP-së për dorëzimin e pronës dhe drejtori i ndërmarrjes, është i detyrueshëm.

Marrja në dorëzim e ndërmarrjes ose objektit nga blerësi bëhet sipas procedurave të këtij vendimi.

16. Nuk lejohet të bëhet kalimi kapital i objekteve që janë publikuar për shitje.

17. Për shitjet e bëra nga AKP-ja dhe degët e saj në rrethe do të njoftohet Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit në datën 20 të çdo muaji.

IV. Detyrat dhe të drejtat për zbatimin e këtij vendimi:

1. Në zbatim të pikës 7 të kapitullit të I-rë të këtij vendimi, ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit të hartojë kriteret e rivlerësimit për kulturat drufrutore, vreshtat dhe ullishtet në prodhim a në rritje, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

2. Komisioni i vlerësimit të pronës shtetërore miratohet nga drejtori i ndërmarrjes ose institucionit ku kryhet vlerësimi i pasurisë shtetërore. Në komision do të bëjë pjesë detyrimisht kryetari i degës së financës ose përgjegjësi i llogarisë së ndërmarrjes dhe kryesohet nga drejtori a zëvendësi i tij.

Në ndihmë të komisionit, për përcaktimin në mënyrë sa më të drejtë dhe reale të vlerësimit, veç pjesëtarëve të komisionit, aktivizohen edhe ekspertë vlerësues të fushave të ndryshme, sipas kërkesës së ndërmarrjes ose institucionit. Organi qendror ose pushteti lokal, sipas vartësisë administrative të ndërmarrjes, miratojnë ekspertët vlerësues të fushave përkatëse.

Anëtarët e komisionit, për periudhën e vlerësimit të pronës shtetërore, përfitojnë një pagesë suplementare mbi pagën bazë. Shpenzimet për këto pagesa kryhen dhe evidentohen nga ndërmarrja ose institucioni që kryen vlerësimin e pasurisë.

Masa e shpërblimit mbi pagën bazë të anëtarëve të komisionit të vlerësimit të pasurisë shtetërore do të jetë:

a) Anëtarët e komisionit që janë punonjës të ndërmarrjes ose institucionit përfitojnë një shtesë 30 për qind mbi pagën bazë që kanë pasur. Këtë masë shpërblimi e përfiton edhe drejtori i ndërmarrjes a institucionit, pavarësisht nëse është anëtar i këtij komisioni.

b) Ekspertët vlerësues të pasurisë shtetërore përfitojnë një shtesë 50 për qind mbi pagën bazë, për ditët e pjesëmarrjes në vlerësim. Kur ekspertët janë profesionistë të lirë, pagesa e tyre është 1000 (një mijë) lekë në ditë.

Ditët e pjesëmarrjes në vlerësimin e objektit përcaktohen nga data e fillimit të vlerësimit, theksuar në dokumentin e miratimit të komisionit, deri në datën e dërgimit të vlerësimit të pasurisë nga ndërmarrja ose institucioni në organet e privatizimit. Komisioni i vlerësimit të pasurisë shtetërore mban përgjegjësi ligjore për saktësinë e veprimeve të kryera.

c) Afati i përfundimit të vlerësimit të objekteve është brenda 30 ditëve nga marrja e urdhrat për privatizim nga ministria përkatëse ose dega e shoqërive publike dhe, brenda këtij afati, dokumentacioni i kalon degës së shoqërive publike në rrethe. Degët e shoqërive publike në rrethe, brenda 10 ditëve, përcjellin dokumentacionin në degën e Agjencisë Kombëtare të Privatizimit, brenda 15 ditëve nga data e ardhjes së dokumentacionit.

3. Agjencia Kombëtare e Privatizimit, brenda 15 ditëve nga marrja e dokumentacionit për privatizim, cakton përfaqësuesin e saj për dorëzimin e pronës. Detyra e përfaqësuesit është që dorëzimi i pasurisë shtetërore të ndërmarrjeve që privatizohen, sipas inventarit të kryer në momentin e vlerësimit të kësaj pasurie, dhe përgatitja e bilancit të likuidimit të kësaj pasurie shtetërore. Për diferencat fizike të lindura ndërmjet periudhës së vlerësimit dhe marrjes në mbikëqyrje mbahet një procesverbal me drejtorin e ndërmarrjes, ku evidentohen diferencat fizike dhe arsyet e krijimit, nxirren përgjegjësitë, kërkohet zhdëmtimi i tyre dhe bëhet kallëzimi në organet e drejtësisë për diferencat e papërligjura.

Drejtori i ndërmarrjes dhe përfaqësuesi i AKP-së janë përgjegjës për dorëzimin e pronës te blerësi.

AKP-ja, brenda 10 ditëve nga përfundimi i lidhjes së kontratës me blerësin, njofton Ministrinë e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe organin që ka në vartësi administrative ndërmarrjen, për lidhjen e kontratës.

Përfaqësuesi i AKP-së dhe drejtori i ndërmarrjes janë të detyruar të përfundojnë evidencimin me procesverbal të objektit që privatizohet brenda 20 ditëve nga data e dhënies së autorizimit blerësit

nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit.

Procesverbali i evidencimit firmoset nga përfaqësuesi i AKP-së, drejtori dhe nga fituesi i së drejtës së blerjes së objektit dhe shërben si akt dorëzimi i pasurisë. Pas pagesës së plotë të vlerës së objektit, lidhet kontrata e shitjes, e cila firmoset nga përfaqësuesi i AKP-së për dorëzimin e pronës, drejtori i ndërmarrjes dhe fituesi i së drejtës së blerjes.

Paga e përfaqësuesit të AKP-së është për 20 ditë me një shtesë 50 për qind më e lartë se paga e drejtorit të objektit që merr për dorëzimin.

Për rastet kur ka vështirësi në dorëzimin e objekteve, afati 20-ditor i dorëzimit zgjatet me autorizim të Agjencisë Kombëtare të Privatizimit.

4. Procesverbali i firmosur i evidencimit dorëzohet brenda afatit 20-ditor pranë degës së AKP-së të rrethit përkatës. AKP-ja i kthen vlerën e munguar blerësit, duke u bazuar në diferencat e përligjura të evidencuara me procesverbalet përkatëse.

Përfaqësuesi i AKP-së dhe drejtori i ndërmarrjes që privatizohet kanë të drejtë marrin specialistë ekspertë për dorëzimin e pronës shtetërore, kur ndërmarrja e ka vazhduar veprimtarinë dhe kur vërehen mungesa fizike në njësitë e inventarit. Gjatë procesit të dorëzimit çdo blerës ka të drejtë të asistojë ose të autorizojë një përfaqësues të tij.

Kur blerësi e ka fituar të drejtën e blerjes së pronës shtetërore nëpërmjet ankandit dhe ka diferenca (mungesa) në dorëzimin e objektit, vlera e kthimit të diferencave do të jetë vlera e mungesave fizike, të rezultuara sipas VAM-it, shumëzuar me masën e rritjes së vlerës së ankandit në krahasim me vlerën fillestare të ankandit për objektin e shitur. Blerësit i kthehet kjo vlerë me urdhër të Agjencisë Kombëtare të Privatizimit.

5. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 589, datë 16.10.1995 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që do të privatizohet dhe përcaktimin e qirasë së objekteve që u jepen në përdorim të tretëve” dhe vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 781, datë 1.11.1996 “Për privatizimin e ndërmarrjeve dhe objekteve shtetërore”, si dhe udhëzimi në zbatim të tij shfuqizohen.

6. Në zbatim të këtij vendimi nuk do të përfshihen dokumentet e vlerësimit të objekteve që kanë filluar procedurat e privatizimit nga AKP-ja para daljes së këtij vendimi.

7. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Agjencia Kombëtare e Privatizimit të nxjerrin udhëzimin përkatës në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

Vendndodhja e objekteve të paluajtshme	Shtesa	Pakësime
a) Në rrethet ose qytetet Tiranë, Berat, Durrës, Fier, Korçë, Lushnjë, Pogradec, Sarandë, Shkodër, Elbasan, Vlorë ose në qendrat e banuara turistike, ku përfshihen zonat e përcaktuara nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 88, datë 1.3.1993 “Për miratimin e zonave që kanë përparësi në zhvillimin e turizmit”		
-Zonat e thella malore jo turistike	-	30%
-Jashtë vijave kufizuese të qyteteve të mësipërme (pika a)	15%	
-Brenda vijave kufizuese të qyteteve të mësipërme (pika a), përveç pjesëve që përfshihen më poshtë.	50%	
-Në rrugët kryesore dhe segmente rrugësh me trafik të dendur (RR.K.S.T.D) të qyteteve Fier, Lushnjë, Berat, qendrat e banuara të përshkruara në pikën a.	60%	
Në RR.K.S.RR.T.D të qyteteve Tiranë, Durrës, Vlorë, Shkodër, Elbasan, Korçë, Pogradec, Sarandë	70%	
b) Në rrethet ose qytetet Delvinë, Gjirokastrë, Kavajë, Krujë, Laç e Lezhë.		
-Në zonat e thella malore jo turistike		
-Jashtë vijave kufizuese të qyteteve të mësipërme (pika b)		
Brenda vijave kufizuese të qyteteve (pika b)	35%	
-RR.K.S.RR.T.D të qyteteve të pikës b	50%	
c) Në rrethet ose qytetin e Devollit, Kolonjës, Mallakastrës, Peqinit, Tepelenës, Peshkopisë, Kukësit, Përmetit dhe qytetet e qendrat e tjera me 10-20 mijë banorë		
-Në zonat e thella malore turistike		55%
-Jashtë vijave kufizuese të qyteteve e qendrave më sipër (pika c)		20%
-Brenda vijave kufizuese të qyteteve e qendrave më sipër (pika c)		
-RR.K.S.RR.T.D në qytetet e qendrat (pikës c)	10%	
d) Në rrethet ose qytetet Bulqizë, Gramsh, Has, Kuçovë, Librazhd, Malësi e Madhe, Mat, Mirditë, Pukë, Skrapar, Tropojë e qendra të tjera nën 10.000 banorë		
-Në zonat e thella malore joturistike		70%

- Jashtë vijave kufizuese të qyteteve e qendrave të mësipërme (pika d)		25%
Brenda vijave kufizuese të qyteteve e qendrave të mësipërme (pika d)		20%
- RR.K.S.RR.T.D në qytet e qendra (pika d)		15%
e) Në zonat e pikave doganore	35%	

NDËRMARRJA Pasqyra nr.1
INSTITUCIONI
OBJEKTI

Gjendja faktike e mjeteve kryesore dhe vlerësimi i tyre në kohën e përfundimit të vlerësimit

	Emërtimi	Vl fillestare e ndërtim prodhim apo çmimi i bler sipas kontabilitetit ose vlerësimit të bërë nga komisioni i vlerësimit në 000/lekë	Amortizimi për investimet në 000/lekë	Vlera e mbetur në 000/lekë		Vlefte e llogaritur me grup ekspertësh	Vlefte e korrigjuar me indeksin e çmimeve	Vlera e korrigjuar me koeficientin e vendodhjes	Sipërfaqja m2	
				V.fillestare minus amortizimin sipas kontabilitetit	Vlefte e llogaritur me grup ekspertësh				Gjithsej	NNga kjo nën objekt
	A	b	c	ç	d	e	f		d	
1	Ndërtesa gjithsej									
2	Instal.pajisje transmesioni									
3	Makineri dhe pajisje energjitike									
4	Makineri dhe pajisje pune									
5	Instrumente dhe vegla									
6	Mete transporti									
7	Kafshë pune dhe prodhimi									
8	Kulturë drufrutorë									
9	Inventar ekonomik									
10	Të tjera Shuma									
11	Vlefte e tokës									
	Totali									

KOMISIONI I VLERËSIMIT

() () ()
()

Shënim: Kjo pasqyrë plotësohet nga komisioni i vlerësimit, duke u mbështetur në dokumentacionin përkatës kontabël, llogaritjet e matjet e kryera prej tij në bazë të legjislacionit me fuqi, si dhe dokumenteve e proces verbaleve të tjera që shërbejnë për këtë qëllim.

NDËRMARRJA

INSTITUCIONI

OBJEKTIPasqyra nr.2

Gjendja faktike dhe vlerësimi për çdo objekt në kohën e përfundimit të vlerësimit

Emërtimi	Viti I		Vlera fillestare e prodhimit apo çmimit të blerjes sipas kontabilitetit ose vlerësimit 000/lek	Amortizimi sipas kontabilitetit për investimet në 000/lekë	Vlefte e mbetur ne 000/lekë		Vlefte e llogaritur me koeficientin e çmimeve	Vlefte e llogaritur me koeficientin e vendodhjen	Sipërfaqja m2	
	Ndërtimit prodhimit ose blerjes	Vënies në shfrytëzim			Vlefte fillestare minus amortizimin sipas kontabilitetit	Vlefte e llogaritur me grup ekspertësh			Gjithsej	NNga kjo nën objekt
a	b	c	ç	d	e	f	g	m	o	q
I.Vlefte e objektit										
Nga këto:										
1.Mjete kryesore										
a) Ndërtim montime										
b) Makineri pajisje										
c)Inventar ekonomik										
ç)Të tjera										
2.Mjete xhiro										
3.Toka										
Shuma										

KOMISIONI I VLERËSIMIT

() () ()
()

Shënim: Pasqyra plotësohet nga komisioni i vlerësimit, mbështetur në dokumentacionin përkatës kontabël, llogaritjet e matjet e kryera prej tij, në bazë të legjislacionit në fuqi, si dhe dokumenteve dhe procesverbaleve të tjera që shërbejnë për këtë qëllim.

NDËRMARRJA _____

INSTITUCIONI _____

OBJEKTI _____

Pasqyra nr.3

Gjendja faktike dhe vlerësimi i mjeteve të xhiros (pa likuiditetet në kohën e përfundimit të vlerësimit.

Nr	Emërtimi	Grupi A	Grupi B	Grupi C
		Me vlerë aktuale kontabël, jo më shumë se vlera në tregun aktual	Me vlerë kontabël në kohën e blerjes, jo më shumë se vlera në tregun aktual	Me vlerë kontabël x koeficientin 0.1
a		b	c	d

1.Lëndë të para e materiale kryesore

2.Materiale ndihmëse

- NDËRMARRJA
INSTITUCIONI
OBJEKTIPasqyra Nr.5

Gjendja faktike dhe vlerësimi i investimeve në proces, në momentin e përfundimit të vlerësimit.

000/lekë

r	Emërtimi	Vlera fillestare e ndërtimit, prodhimit apo çmimi i blerjes sipas situacionit e dokumenteve të tjera kontabël	Vlefte e shitjes e llogaritur me koeficientin e vendodhjes	Sipërfaqja	
		Para korigjimit	Pas korigjimit me indeksin e çmimit	Gjithsej	Nën objekt
	a	b	C (b x indeks)	C (c x shtes)	d e

I. Vlefte gjithsej

Nga këto:

1. Ndërtim montime
2. Makineri pajisje
3. Investime të tjera
4. Studime
5. Mjete xhiruese pranë objektit
6. Vlefte e tokës

Shuma: _____

KOMISIONI I VLERËSIMIT

() () ()
()

Shënim: Të dhënat për plotësimin e kësaj pasqyre të merren nga situacioni i ndërtimit të objektit të dokumenteve e procesverbaleve përkatëse kontabël që vërtetojnë kryerjen e shpenzimeve, si dhe llogaritjen e matjet e bëra direkt nga komisioni i vlerësimit. Kollona “C” tregon vlerën fillestare të korigjuar me indeksin e çmimeve të konsumit.

NDËRMARRJA

INSTITUCIONI

OBJEKTI

Pasqyra nr.7

Disa tregues përmblledhës të ndërmarrjes ose të institucionit që do të privatizohet.

Nr.	Emërtimi	Njësia e matjes	Në kohën e përfundimit të vlerësimit	Vërejtjet
1	Vlera e shitjes së mjeteve kryesore	000/lekë		
2	Vlera e shitjes së mjeteve xhiruese	000/lekë		
3	Vlera e shitjes së investimeve në proces	000/lekë		
4	Shuma 1-2-3			
5	Fitimi për një punonjës			
6	Humbja për një punonjës			
7	Kërkesat e paraqitura për privatizim			
	Nga këto:			
	Blerje direkte			
	Aksione			
	Ankand			
8.	Vlera e ose e dhënies me qera të tokës			

KOMISIONI I VLERËSIMIT

() () ()
()

NDËRMARRJA _____
INSTITUCIONI _____
OBJEKTI _____
Pasqyra nr.6

Të dhënat Ekonomiko-Financiare të ndërmarrjes ose institucionit që privatizohet

Nr	Emërtimi	Vitet		
		Paraardhës	Ekzistues	Parashikues
1.	Sipërfaqja e objektit dhe ambienteve që disponon ndërmarrja	M2		
2.	Sipërfaqja e tokës e punuar	M2		
3.	Vëllimi i prodhimit industrial i shitur	000/lekë		
4.	Vëllimi i prodhimit bujqësor	000/lekë		
5.	Volumi i punimeve në S.M.T	000/lekë		
6.	Volumi i riparim shërbimeve meremetimeve	000/lekë		
7.	Volumi i transportit të mallrave	000/lekë		
8.	Volumi i ndërtim-montimeve	000/lekë		
9.	Qarkullimi i mallrave gjithsej	000/lekë		
10.	Vëllimi i investimeve	000/lekë		
11.	Importi gjithsej (çmimi i blerjes)	000/lekë		
12.	Eksporti gjithsej (çmimi i shitjes)	000/lekë		
3.	Numri i punonjësve	Nr.		
14.	Fondi i pagave	000/lekë		
15.	Fitimi gjithsej	000/lekë		
	Nga ky i derdhur në buxhet	000/lekë		
16.	Humbje gjithsej	000/lekë		
17.	Gjendje financiare	000/lekë		

KOMISIONI I VLERËSIMIT

() () () ()

V E N D I M Nr. 194, datë 20.3.1998

PËR KRITERET E PËRCAKTIMIT TË KAPITALIT THEMELTAR TË SHOQËRIVE SHTETËRORE QË DO TË KRIJOHEN NGA SHDËRRIMI I NDËRMARRJEVE SHTETËRORE NË SHOQËRI TREGTARE

Në zbatim të nenit 11 të ligjit nr.7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve në shoqëri tregtare”, me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përcaktimi i kapitalit themeltar të shoqërive shtetërore që do të krijohen nga transformimi i ndërmarrjeve shtetërore pas datës 31.1.1998 do të bëhet duke u mbështetur në gjendjen e pasurisë së

ndërmarrjes në mbyllje të ushtrimit financiar vjetor.

2. Kapitalit themeltar të ndërmarrjes shtetërore, në datën e transformimit në shoqëri tregtare, do t'i bashkohen :

- a) shuma e rezervës së zhvillimit;
- b) shuma e rezervës së shpërblimit suplementar që mbetet pas heqjes së pjesës së caktuar ose të dhënë punonjësve për ushtrimin e fondit financiar të mbyllur.
- c) shuma e rezervës për ndihma të menjëhershme që tejkalon 5% të fondit të pagave për periudhën që mbetet deri në mbylljen e ushtrimit;
- d) shuma e rezervave të tjera, me përjashtim të rezervave për ndërtimin e banesave për punonjësit, kur këto gjenden në ndërtim e sipër;
- e) shuma që përfaqëson 85% të diferencave nga rivlerësimi të përcaktuar sipas pikës 5 të këtij vendimi;
- f) vlera e truallit sipas aktvlerësimit të lëshuar nga seksioni i financës dhe urbanistikës të bashkisë a këshillit të rrethit;
- g) kapitalit themeltar të ndërmarrjes shtetërore, në datën e transformimit në shoqëri, do t'i zbriten humbjet e pësuar deri në këtë datë, si dhe shpenzimet për t'u shpërndarë në disa ushtrime që nuk janë të mbuluara nga një provizion, dhe shpenzimet për asistencë.

3. Kërkesat debitore dhe detyrimet kreditore ndërmjet ndërmarrjeve shtetërore me njëra-tjetrën do të inventarizohen dhe do të paraqiten në bilancin e riformuar të shoqërisë shtetërore që do të krijohet nga transformimi i ndërmarrjes.

Ndërmarrjet shtetërore ose shoqëritë shtetërore mund të kryejnë kompensimin e detyrimeve të ndërsjella ndërmjet tyre.

Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit mund të urdhërojë një ndërmarrje a shoqëri shtetërore të heqë dorë nga kërkimi i detyrimit mbi një ndërmarrje ose shoqëri shtetërore tjetër, kur një gjë e tillë nuk sjell për kreditorin pakësimin e kapitalit nën kufijtë e përcaktuar nga ligji nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare".

4. Kërkesat debitore të ndërmarrjes mbi buxhetin e shtetit dhe mbi institucionet e tjera buxhetore, qendrore dhe lokale, si dhe detyrimet kreditore të ndërmarrjes ndaj këtyre të fundit, do të inventarizohen veçmas dhe do të paraqiten më vete në bilancin e riformuar të shoqërisë që do të krijohet nga transformimi i ndërmarrjes. Sistemimi i këtyre kërkesave dhe detyrimeve mund të bëhet vetëm me ligj të veçantë.

5. Vlera kontabël e mbetur e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara aktuale të rivlerësohen sipas kriterëve të caktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.192, datë 20.3.1998 "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet dhe procedura e shitjes".

6. Elementet e pasurisë pa vlerë, përdorimi ose të zhvlerësuar të trajtohen, në nxjerrjen e tyre jashtë përdorimit ose në uljen e vlerës, në pajtim me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.170, datë 3.4.1993. Ulja e vlerës do të kryhet nga komisioni i vlerësimit dhe me pjesëmarrjen e dy a më shumë ekspertëve të fushave përkatëse, në varësi nga natyra e elementeve të pasurisë.

7. Bilanci i çeljes së shoqërisë së krijuar nga transformimi i ndërmarrjes shtetërore do të jetë bilanci i riformuar.

8. Përcaktimi i kapitalit të shoqërive shtetërore do të bëhet nga një komision i ngritur pranë çdo ndërmarrjeje me urdhër të titullarit të saj.

9. Bilanci i çeljes së shoqërisë do të verifikohet dhe vërtetohet nga një ekspert kontabël i autorizuar, i zgjedhur sipas listës së dërguar nga Instituti i Ekspertëve Kontabël, të autorizuar dhe miratuar nga Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

10. Madhësia e kapitalit themeltar të nevojshëm për shoqëritë që krijohen nga transformimi i ndërmarrjeve shtetërore, vendoset nga Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit ka të drejtë të caktojë (kur ndërmarrja ka gjendje të shëndoshë financiare) një shumë kapitali më të vogël se shuma që del nga llogaritjet e bëra sipas këtij vendimi dhe të urdhërojë tërheqjen e diferencës në një llogari të posaçme të fondit rezervë të Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

11. Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit të hartojë udhëzimin përkatës për zbatimin e këtij vendimi.

12. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 311, datë 12.6.1995 "Për kriteret e përcaktimit të kapitalit themeltar të shoqërive shtetërore që do të krijohen nga shndërrimi i ndërmarrjeve shtetërore

në shoqëri tregtare” dhe vendimi i Këshillit të Ministrave nr.85, datë 2.2.1996 “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 311, datë 12.6.1995”, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr. 195, datë 20.3.1998

PËR PRIVATIZIMIN E NDËRMARRJEVE QË NUK MUND TË TRANSFORMOHEN

Në mbështetje të ligjit nr. 7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, ndryshuar me ligjin nr.8159, datë 7.11.1996, me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Objekti i këtij vendimi janë ndërmarrjet, të cilat sot për sot e kanë ndërprerë veprimtarinë ekonomike dhe nuk plotësojnë kriteret e transformimit në shoqëri tregtare, në zbatim të ligjit nr. 7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëritë tregtare”, ndryshuar me ligjin nr.8237, datë 1.9.1997 dhe ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”.

2. Lista e ndërmarrjeve me të dhënat përkatëse i dërgohet Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit nga organet qendrore dhe pushteti lokal, sipas vartësisë administrative të ndërmarrjeve. Kjo listë publikohet me urdhër të Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit

3. Format e privatizimit janë:

- shitja;
- shitja me rezervë;
- kontrata e enfiteozës;

4. Përzgjedhja e formës së privatizimit bëhet nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, sipas propozimeve të bëra në ofertat parakualifikuese, duke i dhënë përparësi shitjes.

5. Për shitjen dhe shitjen me rezervë ngarkohet AKP-ja ta realizojë atë në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 192, datë 20.3.1998 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet, si dhe procedura e shitjes”.

6. Kontrata e enfiteozës lidhet nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit sipas dispozitave të Kodit Civil në fuqi.

7. Vlerësimi i kapitalit të ndërmarrjeve dhe dokumentacioni përkatës për privatizim përgatiten sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 192, datë 20.3.1998 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohen, si dhe procedura e shitjes”. Afatet e vlerësimit përcaktohen me urdhër të Ministrit. Për drejtuesit që pengojnë procesin e privatizimit, të merren masa disiplinore sipas nenit 7 të ligjit nr. 7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, ndryshuar me ligjin nr. 8237, datë 1.9.1997.

8. Ndryshimet në kapitalet e ndërmarrjeve për nevojë të ristrukturimit bëhen me urdhër të Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr. 201 , datë 26.3.1998

PËR KRITERET E PËRDORIMIT TË ARDHURAVE NGA SHITJA DHE QIRAJA E TRUALLIT

Mbështetur në nenin 21 të ligjit nr. 7512, datë 8.10.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, nismës së lirë, veprimtarisë private të pavarur dhe privatizimit”, me propozimin e Sekretariatit Shtetëror për Pushtetin Lokal, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Të ardhurat nga shitja dhe dhënia me qira e trojeve të ndahen nga dega e thesarit si vijon:
 - 30% e vlerës totale të të ardhurave të arkëtuara kalon në favor të buxhetit të këshillit të rrethit;
 - 70% e vlerës totale të të ardhurave të arkëtuara kalon në favor të organit të pushtetit lokal, nën juridiksionin e të cilit ndodhet trualli i shitur ose i dhënë me qira.
- Bashkia e Tiranës përfiton 100% të të ardhurave që realizohen nga shitja dhe dhënia me qira e trojeve nën juridiksionin e saj.
2. Pjesa e të ardhurave të arkëtuara nga shitja dhe qiraja e trojeve i lihet pushtetit lokal, i cili e administron në formën e buxhetit të pavarur dhe e përdor:
 - për studime, projekte dhe zbatime në infrastrukturë, si rrugë, kanalizime, ujësjellës, telefoni, shkolla, qendra shëndetësore etj.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet e tij financiare që nga 1 janari 1998.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M **Nr. 202, datë 26.3.1998**

PËR DETYRAT E APARATIT ADMINISTRATIV TË PREFEKTURËS

Në zbatim të ligjit nr.7608, datë 22.9.1992 “Për prefekturat”, ndryshuar me ligjin nr. 8209, datë 22.4.1997, me propozimin e Sekretariatit Shtetëror për Pushtetin Lokal, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në prefektura organizohet aparati administrativ që siguron realizimin e funksioneve, të cilat me ligj i ngarkohen prefektit, sipas strukturës tip që i bashkëngjitet këtij vendimi.
Struktura dhe numri i punonjësve në organikë për çdo prefekturë miratohet nga Kryetari i Këshillit të Ministrave, me propozim të Sekretariatit Shtetëror për Pushtetin Lokal.
2. Prefektura ka një sekretar të përgjithshëm, i cili emërohet dhe shkarkohet nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Sekretarit të Shtetit për Pushtetin Lokal.
3. Sekretari i përgjithshëm i prefekturës përgatit dhe merr masa organizative për zhvillimin e mbledhjeve të këshillit administrativ, mbledhjeve të përmuajshme të punës në çdo rreth dhe kontrollon e ndjek zbatimin e urdhrave, udhëzimeve e vendimeve të nxjerra nga prefekti. Ai kryen të gjitha detyrat që i delegohen nga prefekti dhe është përgjegjës përpara tij për zbatimin e tyre. Në mungesë të prefektit, përgjigjet përpara Këshillit të Ministrave për detyrat që me ligj i ngarkohen prefekturës.
4. Kabineti i prefektit përbëhet nga sekretari i përgjithshëm, si dhe përgjegjësit e zyrave të prefekturës dhe përfaqësuesit rajonal të prefektit.
5. Emërimi dhe shkarkimi i personelit të aparatit administrativ bëhet nga prefekti.
6. Pagat e personelit të aparatit administrativ të prefekturës caktohen sipas akteve përkatëse të Këshillit të Ministrave.
7. Prefektët dhe sekretarët e përgjithshëm, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, informojnë dhe komunikojnë me Këshillin e Ministrave nëpërmjet Sekretariatit Shtetëror për Pushtetin Lokal. Për

probleme të veçanta, sipas fushave, informojnë dhe kontaktojnë drejtpërdrejtë me titullarët e ministrive dhe institucioneve qendrore përkatëse.

8. Prefektët dhe sekretarët e përgjithshëm mbajnë kontakte të vazhdueshme pune me sekretarët e këshillave lokalë, për t'u informuar lidhur me zbatimin e akteve ligjore e nënligjore.

9. Aparati administrativ i prefekturës kryen këto detyra:

A. Në fushën e kontrollit të akteve

a) Brenda shtatë ditëve nga miratimi, grumbullon aktet (vendimet, urdhëresat dhe rregulloret) që nxjerrin organet e pushtetit lokal në komuna, bashki e rrethe të territorit që përfshin prefektura. Në rast mosrespektimi të detyrimit ligjor, i propozon prefektit masat që duhen marrë.

b) Verifikon ligjshmërinë e akteve të nxjerra nga organet e pushtetit lokal në komuna, bashki e rrethe dhe i relaton prefektit, nëpërmjet sekretarit të përgjithshëm, sidomos për rastet kur vëren shkelje ligjore.

c) Përpilon dokumentacionin e nevojshëm, duke u shprehur për ligjshmërinë e akteve të kontrolluara nga prefektura, brenda 10 ditëve nga dita e ardhjes së aktit në prefekturë. Pas miratimit nga prefekti, njofton zyrtarisht organin përkatës të pushtetit lokal.

ç) Kur vërehet se akti që ka nxjerrë organi i pushtetit lokal është i kundërligjshëm, veprohet sipas nenit 6 paragrafi i tretë i ligjit nr.8209, datë 22.4.1997 "Për prefekturat".

d) Çdo tre muaj përpilon raporte dhe informacione për prefektin në lidhje me zbatimin e ligjeve dhe akteve të tjera nënligjore nga organet e pushtetit lokal që përfshihen në territorin e prefekturës. Në mënyrë të përmblodhur dhe për probleme me interes kombëtar, përgatit raporte për Këshillin e Ministrave me propozime përkatës.

dh) Ndjek zbatimin e urdhrave, udhëzimeve dhe vendimeve të prefektit dhe informon për shkeljet e mundshme të tyre.

e) Jep ndihmën juridike në hartimin e urdhrave, udhëzimeve e të vendimeve që u paraqiten, sipas kompetencës, prefektit ose këshillit administrativ nga aparati përkatës.

B. Në fushën e kontrollit dhe mbikëqyrjes së veprimtarisë së administratës shtetërore në nivel lokal dhe asaj të pushtetit lokal.

a) Kontrollon në mënyrë të programuar zbatimin e buxhetit të shtetit në këto administrata.

b) Kontrollon tërësinë e veprimtarisë së tyre për të siguruar një zbatim sa më efektiv të akteve ligjore e nënligjore të organeve të larta shtetërore, si dhe të akteve të administratës shtetërore në nivel lokal.

c) Përgatit propozime për Sekretariatit Shtetëror të Pushtetit Lokal, i cili, pasi i shqyrton ato, ia paraqet për miratim Këshillit të Ministrave.

C. Për probleme të bashkërendimit të veprimtarisë së organeve të administratës shtetërore në nivel lokal.

a) Paraqet periodikisht dhe sipas rastit, njoftime lidhur me respektimin e ligjeve e të rendit publik në territorin e prefekturës dhe i bën propozime prefektit për masat përkatëse.

b) Periodikisht dhe sa herë që lind nevoja nga ngjarje me karakter të veçantë, informon prefektin për organizimin dhe zbatimin e masave që nuk kanë karakter ushtarak. Mban kontakt të përhershëm me autoritetet ushtarake dhe të policisë për të informuar prefektin në kohën e duhur lidhur me çdo problem që paraqet rëndësi për sigurimin e shtetasve e të pasurisë shtetërore e private.

c) Mbi bazën e informacioneve sistematike nga ana e drejtuesve të administratës shtetërore në nivel lokal, informon prefektin për gjithë problematikën sipas fushave përkatëse dhe bën propozimet e nevojshme.

ç) Informon periodikisht prefektin për veprimtarinë e organeve të administratës shtetërore të organizuara dhe zhvilluara në komuna, bashki dhe rrethe, sinjalizon për mosmarrëveshjet e mundshme ndërmjet tyre dhe organeve të administratës së pushtetit lokal dhe mbi këtë bazë propozon zgjidhjet përkatëse.

d) Nëpërmjet organizmave të specializuar, siguron të dhëna kryesore e statistikore lidhur me gjendjen ekonomike, sociale, kulturore dhe administrative për territorin e vet dhe harton çdo vit një raport të përgjithshëm, i cili i dërgohet Sekretariatit Shtetëror për Pushtetin Lokal.

dh) Ndjek e informon prefektin lidhur me realizimin e masave për inventarizimin e pasurisë

shtetërore e private në komuna, bashki e rrethe, për punën që bëhet për administrimin e rregullt të pasurisë shtetërore, për zbatimin e detyrimeve që kanë subjektet private dhe administruesit e pasurisë shtetërore ndaj shtetit dhe propozon masat përkatëse.

Ç. Për problemet administrative të prefekturës

a) Organizon dhe përgatit mbledhjet e këshillit administrativ të prefekturës, duke marrë masat në kohë për kryerjen e analizave dhe shpërndarjen e materialeve të nevojshme (raporte, njoftime, projektvendime, projektudhëzime e projekturdhra)

b) Pas zgjedhjeve të përgjithshme ose të pjesshme, siguron konstituimin e këshillave lokalë.

c) Përgatit dhe i paraqet prefektit për miratim projekturdhra, projektudhëzime ose projektvendime, në zbatim të kompetencave të tij, dhe ndjek dërgimin e tyre në organet e organizmat përkatës të ngarkuar për zbatim, si dhe, kur gjykohet nga prefekti, bën publikimin e tyre.

ç) Dërgon për zbatim dispozitat dhe aktet, në të cilat caktohen atributet detyra për prefektin.

d) Ndjek problemet financiare të administratës së prefekturës, pajisjen me mjetet dhe bazën e nevojshme materiale e për mirëmbajtjen e saj.

dh) Organizon ruajtjen dhe administrimin e rregullt të dokumentacionit të prefekturës, në përputhje me dispozitat në fuqi.

e) Organizon pritjen e banorëve për problemet që ata ngrenë, në përputhje me funksionet e prefekturës.

f) Në bazë të akteve që rregullojnë fushën e marrëdhënieve me organizma shtetërorë e joshtetërorë të huaj, përgatiti organizimin e veprimtarive me këta organizma dhe parashikon shpenzimet dhe të ardhurat e nevojshme.

g) Përgatit projekt marrëveshje ose protokolle për probleme që do të trajtohen nga organizma të huaj analogë ose institucione ndërkombëtare, të cilat miratohen nga prefekti dhe nënshkruhen nga ai në emër të Këshillit të Ministrave pasi të jetë marrë miratimi i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe i Sekretariatit Shtetëror për Pushtetin Lokal, si dhe ndjek zbatimin e tyre.

D) Detyra të tjera

a) Me urdhër të prefektit, aparati administrativ të tij ose punonjësve të veçantë mund t'u caktohen detyra të veçanta në përputhje me aktet ligjore e nënligjore.

b) Kryetarët e zyrave caktohen me urdhër të brendshëm nga prefekti.

c) Të gjitha projektaktet (projektvendimet, projekturdhrat e projektudhëzimet), përpara se t'i paraqiten prefektit për miratim, në të gjitha rastet kalojnë paraprakisht për shqyrtim në zyrën juridike dhe te sekretari i përgjithshëm i prefekturës.

10. Prefekti miraton me urdhër të veçantë rregulloren e organizimit e të funksionimit të aparatit administrativ të prefekturës.

11. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.228, datë 30.5.1994 "Për strukturën dhe detyrat e aparatit të prefekturës" shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

STRUKTURA TIP E PREFEKTURËS

1. Prefekti

2. Sekretari i përgjithshëm

3. Përfaqësuesi rajonal i prefektit (nivel përgjegjësi zyre)

I. Zyra personel-administratës

1. Përgjegjës zyre

2. Arkiv-protokoll-magazinë-daktilografist

3. Shofer i prefektit

4. Shofer

5. Pastrues

II. Zyra financë-kontroll

1. Përgjegjës zyre (tatim-taksa-dogana-banka-sigurimet shoqërore)
2. Inspektor i financës (buxheti e ndihma ekonomike)
3. Inspektori i kontroll-revizionit
4. Inspektori i kontroll-revizionit
5. Inspektori i prokurimit e privatizimit

III. Zyra juridike

1. Përgjegjës zyre
2. Inspektor jurist
3. Inspektor jurist

IV. Zyra e shërbimeve të ndryshme publike

1. Përgjegjës zyre (duhet të mbulojë një nga sektorët e mëposhtëm)
2. Inspektor për shërbimet e infrastrukturës
3. Inspektor urbanist
4. Inspektor bujqësi, ushqim-shërbim veterinar
5. Inspektor për problemet e punësimit dhe përkrahje sociale

V. Zyra e zhvillimit dhe koordinimit rajonal

1. Përgjegjës zyre që mbulon edhe investimet
2. Inspektor për statistikën

VI. Zyra e arsimit, kulturës, sportit, higjienës, mjedisit

1. Përgjegjës zyre
2. Inspektor

Zyra e rendit, mbrojtjes dhe gjendjes civile

V E N D I M
Nr. 203, datë 26.3.1998

PËR NËNSHKRIMIN E KARTËS EUROPIANE TË AUTONOMISË LOKALE

Me propozimin e Sekretariatit Shtetëror për Pushtetin Lokal, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Të nënshkruhet Karta Europiane e Autonomisë Lokale për nenet dhe paragrafët që vijojnë:
Neni 2 neni 3 paragrafët 1 dhe 2; neni 4 paragrafët 1,2,3,4 dhe 6; neni 5; neni 6; paragrafët 1 dhe 2; neni 7 paragrafët 1 dhe 3; neni 8 paragrafët 1, 2 dhe 3; neni 9 paragrafët 2, 3 dhe 5; neni 10 paragrafët 1, 2 dhe 3, neni 11.

2. Me përmirësimin e gjendjes ekonomiko-shoqërore, të zgjerohet angazhimi i Qeverisë Shqiptare, duke përfshirë nenet dhe paragrafët e tjerë të pjesës së parë të Kartës Europiane të Autonomisë Lokale.

3. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme të nisë procedurat për nënshkrimin e Kartës Europiane të Autonomisë Lokale.

4. Autorizohet Sekretari i Shtetit për Pushtetin Lokal për nënshkrimin e Kartës Europiane të Autonomisë Lokale.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr. 204, datë 26.3.1998

PËR KOMPETENCAT, DETYRAT FUNKSIONALE DHE FINANCIMIN E PUSHTETIT LOKAL

Në mbështetje të ligjit nr. 7572, datë 10.6.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal”, dhe të ligjit nr. 7776, datë 22.12.1993 “Për buxhetin lokal”, me propozimin e Ministrisë së Financave dhe Sekretariatit Shtetëror për Pushtetin Lokal, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Pushteti lokal është kompetent, administron dhe përgjigjet tërësisht për funksionet vijuese:
 - a) administrimin, mirëmbajtjen, furnizimin me materiale të konsumit të përgjithshëm, ujë, energji elektrike, ngrohje, lyerje dhe shërbime të tjera të këtij karakteri për institucionet që përfshihen në aneksin nr.1, që i bashkëngjitet këtij vendimi;
 - b) kryerjen dhe administrimin e shërbimeve sipas aneksit nr.2, që i bashkëngjitet këtij vendimi.
2. Detyrat dhe funksionet e pushtetit lokal të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, ushtrohen dhe realizohen nëpërmjet buxhetit të pavarur të rrethit, bashkisë e komunës. Ky buxhet hartohet në përputhje me udhëzimet e lëshuara nga Ministria e Financave dhe Sekretariatit Shtetëror për Pushtetin Lokal dhe përmban:
 - shpenzimet për ushtrimin dhe realizimin e detyrave dhe funksioneve të mësipërme;
 - të ardhurat, të cilat me ligj u takojnë organeve të pushtetit lokal;
 - diferencën ndërmjet shpenzimeve dhe të ardhurave të buxhetit lokal të pavarur, që financohet nga blloku i ndihmës së pakthyeshme që i jep pushteti qendror secilit organ të pushtetit lokal.
3. Ndihma e pakthyeshme e pushtetit qendror jepet si një shumë totale për çdo komunë, bashki e rreth dhe është pjesë përbërëse e shpenzimeve të buxhetit qendror, që miratohet nga Kuvendi Popullor.

Ajo ndahet në dy grupe:

 - a) për investime (rikonstruktive e mirëmbajtje); dhe
 - b) shpenzime operative.

Pjesa e ndihmës për investime zërthehet në objektet në përputhje me politikën e ministrive përkatëse për rrjetin institucional. Për shpenzimet operative, këshillat lokale miratojnë prioritetet dhe strukturat e përdorimit të burimeve financiare në dispozicion si nga burimet lokale, ashtu edhe nga buxheti qendror.

Ndihma e pakthyeshme e pushtetit qendror do të jetë e ndryshme për çdo komunë, bashki e rreth, në varësi nga gjendja dhe mundësitë e përmirësimit të rrjetit të institucioneve dhe infrastrukturës lokale.
4. Organet e pushtetit lokal ushtrojnë detyra dhe funksione të deleguara nga pushteti qendror, brenda normave ligjore përkatëse dhe buxhetit të miratuar për secilin funksion, si vijon:
 - a) Bashkitë dhe komunat:

kryerjen e pagesave për pagat, shtesat mbi pagë dhe përfitimet e tjera të drejtuesve dhe punonjësve të institucioneve në vartësi të tyre në masën e përcaktuar me akte ligjore e nënligjore dhe brenda numrit të punonjësve në organikën e miratuar për çdo vit;

pagesën e ndihmës ekonomike dhe të përfitimeve të tjera të këtij karakteri në kuadrin e politikës sociale për banorët e regjistruar zyrtarisht në territorin e tyre.

 - administrimin e procesit të privatizimit dhe likuidimit të ndërmarrjeve shtetërore lokale.
 - b) Rrethet:

kryerjen e pagesave për pagat, shtesat mbi pagë dhe përfitimet e tjera të drejtuesve dhe punonjësve të institucioneve në vartësi të tyre në masën e përcaktuar me akte ligjore e nënligjore dhe brenda numrit të punonjësve në organikën e miratuar për çdo vit;

 - administrimin e procesit të privatizimit dhe likuidimit të ndërmarrjeve shtetërore lokale.
5. Detyrat dhe funksionet e deleguara sipas pikës 4 të këtij vendimi ushtrohen dhe realizohen nëpërmjet buxhetit të kushtëzuar të rrethit, bashkisë dhe komunës. Ky buxhet është pjesë përbërëse e buxhetit qendror, që administrohet nga organet e pushtetit lokal. Organet e pushtetit lokal përgjigjen për administrimin e mirë të kësaj pjese të buxhetit dhe nuk kanë të drejtë ta përdorin për qëllime të tjera qofshin ato detyra dhe funksione të tyre të deleguara.

6. Organet e pushtetit lokal janë investitorë për projekte që financohen me burime të huaja, kur caktohen në marrëveshjet përkatëse ose kur ky funksion u delegohet nga institucionet qendrore, nga njësitë e ngarkuara për zbatimin e projekteve, si dhe në marrëveshjet e veçanta që lidhen ndërmjet secilit organ të pushtetit lokal dhe njësisë përkatëse të zbatimit të projektit.

7. Ministria e Financave dhe ministrinë e institucionet e tjera qendrore që mbulojnë funksione të ngjashme me ato të organeve të pushtetit lokal ose u delegojnë funksione këtyre të fundit, me konsulencën e Sekretariatit Shtetëror për Pushtetin Lokal, ngarkohen të përgatitin udhëzimet përkatëse në zbatim të këtij vendimi, brenda muajit prill të vitit 1998.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

ANEKSI 1

I. Lista e institucioneve në vartësi të bashkive/komunave

1. Organet ekzekutive dhe legjislative

Zyrat e organeve të zgjedhura dhe ekzekutive

2. Arsimi:

- a) kopshtet e fëmijëve,
- b) shkollat fillore dhe tetëvjeçare,
- c) shkollat e mesme të përgjithshme,
- d) konviktet e shkollave të mesme,
- e) bazat prodhuese të shkollave të mesme të përgjithshme,
- f) qendrat kulturore të fëmijëve.

3. Shëndetësia:

- a) çerdhet ,
- b) ambulancat dhe klinikat e shërbimit ambulator,
- c) klinikat dentare,
- d) shërbimi DDD.

4. Kultura:

- a) qendra kulturore, ku bëjnë pjesë,
- b) shtëpitë ose pallatet e kulturës,
- c) bibliotekat lokale,
- d) galeritë lokale të artit,
- e) muzetë lokale,
- f) teatrot e kukullave,
- b) kinematë shtetërore,
- c) teatrot lokale,
- d) mjediset sportive lokale ,
- e) përsëritësit televizivë.

5. Ndërtimi, banimi dhe rregullimi i mjedisit:

- a) Vendstrehimet e popullsisë (nën banesë apo të groposura)
- b) Monumentet, lapidarët etj.

II. Lista e institucioneve në vartësi të rretheve

1. Organet ekzekutive dhe legjislative:

- a) zyrat e organeve të zgjedhura dhe ekzekutive lokale;
- b) vendkomandat për kohë lufte (mbi e nëntokësore).

2. Arsimi

- a) qendrat ekonomike të arsimit (sektori ekonomik i drejtorisë arsimore)

ANEKSI 2

I. Lista e shërbimeve në kompetencë të bashkisë/komunës:

1. Organet ekzekutive dhe legjislativë
Është investitor për ndërtimin e zyrave dhe mjediseve të punës për organet e zgjedhura në organet ekzekutive.

2. Bujqësia, ushqimi dhe tregtia
Administrimi i kullotave të komunave
Investimet dhe administrimi i rrjetit ujëtar, në rastet kur burimet ujore janë brenda/afër fshatrave/ qyteteve të komunës/bashkisë dhe rrjeti i shërben vetëm një komunë/bashkie.

Shërbimi veterinar për nevojat e popullsisë dhe kontrolli veterinar në thertore, magazinat frigoriferike, tregun e kafshëve dhe objekte të tjera të kësaj natyre.

Shërbimet e tjera veterinare që kanë të bëjnë me kontrollin e sëmundjeve (lista B, vaksinime, gjurmime, dehelmizime etj.) dhe kontrolli i tregut të mishit dhe bulmetrave.

Lejimi dhe kontrolli i prodhimit sezonal në kushtet e shtëpisë dhe në sasi të kufizuara të pijeve alkoolike për nevojat vetjake.

Ndërtimi, mirëmbajtja dhe administrimi i kanaleve kulluese dhe ujëtare të treta, në rastet kur rrjeti i tyre është i ndarë nga sistemi në shkallë rrethi dhe është brenda territorit të komunës.

Administrimi i pyjeve të dhëna nga Ministria e Bujqësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve në shfrytëzim komunave për banorët e vet.

Organizimi, administrimi dhe kontrolli i tregut të produkteve bujqësore e blegtorale, si dhe i tregtisë ambulante të mallrave industriale.

3. Ndërtimi, banimi dhe rregullimi i mjedisit

Ushtrimi i së drejtës së pronësisë mbi banesat e paprivatizuara brenda territorit të bashkisë/komunës.

Shërbimet publike të mëposhtme:

a) mirëmbajtja e lulishteve, trotuareve dhe parqeve brenda/ në periferi të qytetit/fshatit;
b) sistemi i kanalizimeve, banjot publike, pastrimi , grumbullimi dhe përpunimi i plehrave;
c) shërbimi i funeralit, mirëmbajtja e varrezave publike dhe varrezave të dëshmorëve, monumentet publike, lapidarët etj;

d) investimet dhe administrimi i ujësjellësve, puseve, çezmave dhe burimeve të ujit të pijshëm që i shërbejnë një komunë/bashkie;

e) dekorimi dhe ndriçimi i rrugëve të bashkive/komunave;

f) organizimi dhe realizimi i punëve publike.

4. Transporti dhe komunikacioni

Shërbimi i transportit publik urban dhe taksive urbane.

Ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrjetit lokal që lidh qendrën e komunës/bashkisë dhe fshatrat/lagjet e qytetit, si dhe rrugët brenda fshatit, lagjeve të komunës/bashkisë.

5. Kultura, sporti

Është investitor për ndërtimin e institucioneve dhe monumenteve të tjera të kulturës, dhe sporteve në vartësi.

Zhvillimin e veprimtarive masive kulturore, sportive dhe rinore në shkallë lokale.

II. Lista e shërbimeve në kompetencë të rrethit

1. Organet ekzekutive dhe legjislativë

Është investitor për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e zyrave dhe mjediseve të punës për organet e zgjedhura dhe organet ekzekutive.

2. Arsimi

Furnizimi me materiale mësimore, pajisje shkollore dhe çdo lloj furnizimi tjetër që lidhet me zhvillimin normal të mësimin me përjashtim të pajisjeve laboratorike dhe teksteve shkollore.

Transporti i arsimtarëve dhe nxënësve nga vendbanimet në shkollën ku bëjnë mësim.

Në zbatim të pikës 6 të këtij vendimi, është investitor për meremetimin dhe rikonstruksionin e shkollave dhe institucioneve të tjera arsimore në vartësi të pushtetit lokal dhe pajisjen për funksionimin normal të tyre.

3. Shëndetësia

Mbikëqyrja e shërbimit shëndetësor në shkallë rrethi.

4. Transporti dhe komunikacioni

Transporti publik interurban dhe transporti i mallrave brenda rrethit.

Është investitor për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit rrugor lokal që lidh qendrat e komunave në gjithë rrethin dhe qendrën e komunës me qendrën e rrethit, por që nuk përfshihen në rrjetin e rrugëve kombëtare.

5. Bujqësia

Është investitor për ndërtimin e rrjetit kullues e ujitës, që i shërben më shumë se një komune a bashkie dhe që nuk përfshihet në rrjetin kombëtar të përcaktuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit apo në programe ujitjeje dhe kullimi me karakter kombëtar.

6. Ndërtimi, banimi dhe rregullimi i mjediseve

Është investitor dhe administrator i ujësjellësave që i shërbejnë më shumë se një komune/bashkie dhe që nuk klasifikohen nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit si objekte me karakter kombëtar.

V E N D I M
Nr. 206, datë 26.3.1998

PËR KRITERET PËR PJESËMARRJEN E SHTETIT NË PËRBALLIMIN E DËMEVE NË RAST FATKEQËSISH

Me propozimin e Sekretarit Shtetëror për Pushtetin Lokal, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Kur në zonat urbane dhe rurale ndodh dëmtim apo shkatërrim i banesave në pronësi të shtetasve, shteti mund të marrë pjesë me ndihmë financiare të pjesshme ose të plotë, për lehtësimin e dëmit të krijuar, mbi bazën e kriterëve të përcaktuara në këtë vendim. Shteti ndërhyr kur pasojat janë me rrezik për jetën e njerëzve dhe në këto raste merr masa për lehtësimin e gjendjes dhe mënjanimin e rrezikut për jetën e shtetasve.

2. Këshilli i Ministrave merr pjesë me ndihmë financiare në rastet e dëmtimit të banesave, si pasojë e këtyre faktorëve:

- dëmtime nga tërmetet;
- dëmtime nga rrëshqitjet masive të trojeve;
- dëmtime nga përmytjet masive;
- dëmtime nga zjarret ose për shkaqe të tjera të forcave madhore.

3. Procedura e hartimit të dokumentacionit

Bashkia ose komuna, kur ka raste të dëmtimit të ndërtesave të përmendura në pikën 2 të këtij vendimi krijon menjëherë një komision për hartimin e procesverbaleve të konstatimit të gjendjes. Këshilli i rrethit krijon një komision ekspertësh, të cilët, brenda 10 ditëve nga dita e ngjarjes, bëjnë vlerësimet e mëposhtme:

- a) dëmet në anën ndërtimore;
- b) dëmet në orendi dhe pajisje, në rast se ka.

Këshilli i bashkisë a komunës, pasi shqyrton procesverbalet për konstatimin e gjendjes dhe ato të komisionit të ekspertëve të këshillit të rrethit, merr vendimin për dhënien e ndihmës financiare. Ky vendim i paraqitet SSHPL-së, pas konfirmimit të tij nga prefekti, së bashku me dokumentacionin vijues:

- procesverbalet e konstatimit të gjendjes;
- preventivat (nga ana ndërtimore, orendi e pajisje);
- aktekspertizë nga MNZ-ja për rastet e dëmtimit nga zjarri;
- raporti gjeologjik për rastet e rrëshqitjeve masive të trojeve;
- lista emërore e familjeve të dëmtuara, përbërja familjare në momentin e ngjarjes, e vërtetuar me certifikatë të gjendjes civile; Kjo listë të firmoset nga nëpunësi i gjendjes civile dhe kryetari i bashkisë a komunës.

- vendimi i këshillit të rrethit me propozimet përkatëse, në rastet kur dëmi do të përballohet nga ky organ.

4. Masat e ndihmës për rastet që do të trajtohen me këtë vendim

4.1. Për rastet e shkatërrimit të banesave, masa e ndihmës falas të jetë 40-50% e vlerës së banesës së re. Vlera e banesës së re do të llogaritet mbi bazën e kostos së ndërtimit të banesave nga EKB-ja, për vitin përkatës kur do të llogaritet masa e ndihmës falas. Për rastet kur vlera e tregut të lirë të banesave është më e ulët se vlera e banesës e llogaritur mbi bazën e kostos së ndërtimit të banesave nga EKB-ja, merret për bazë vlera e tregut të lirë të rrethit përkatës. Në të gjitha rastet, sipërfaqja e banesës së re do të jetë e njëjtë me sipërfaqen e asaj ekzistuese. Bëjnë përjashtim rastet, kur sipërfaqja e banimit të banesës së vjetër është mbi normativat e strehimit; në këtë rast sipërfaqja e banesës së re do të llogaritet mbi bazën e përbërjes familjare.

- Në rastet kur është e mundur të përdoren materialet e banesës ekzistuese, ndihma falas do të jepet në masën 40 për qind të vlerës së dëmit..

Për rastet e dëmtimit të mesëm e të lehtë ndihma falas të jetë në masën 50 për qind të vlerës së dëmit.

Për rastet kur ka viktimë në njerëz, jepet një ndihmë e menjëhershme falas në masën 50 000 lekë, për çdo viktimë.

Në të gjitha rastet kur ka dëmtime në pajisje dhe orëndi, pas vlerësimit real të dëmit, jepet ndihma falas deri në 20 000 lekë për frymë, por jo më shumë se 100 000 lekë për familje. Për rastet kur vlera e dëmit është më e vogël se masa e përfitimit falas për frymë, ndihma falas do të jetë e barabartë me vlerën e dëmit.

Në rastet kur zhvendosja e banesave kërkon zgjidhje të problemit me ndërtime masive, atëherë zbatohet ligji nr. 7848, datë 25.7.1994 "Shpronësimet për interes publik". Vlera e zhdëmtimit në lekë përballohet nga shteti.

Në rastet kur banesat janë bërë të pabanueshme, sipas vlerësimit nga komisioni i posaçëm, prefekti paraqet kërkesën në Këshillin e Ministrave (Rezervat e Shtetit apo Ministrinë e Mbrojtjes) për pajisjen me çadra për sistemim të përkohshëm, që vihen në dispozicion sipas gjendjes.

5. Dëmtimet nga tërmetet

Për verifikimin e dëmeve të shkaktuara nga tërmetet, ngrihen komisione ekspertësh në shkallë bashkie, komune a rrethi, të cilat, brenda 10 ditëve nga dita e rënies së tërmetit, hartojnë procesverbalet përkatëse të shoqëruara me preventiva. Dokumentacioni i plotë i përgatitur nga komisionet, pas konfirmimit në prefekturë, i dërgohet Sekretariatit Shtetëror për Pushtetin Lokal, i cili, në varësi nga shtrirja gjeografike dhe përmasat e dëmit, kërkon pranë Këshillit të Ministrave ngritjen e komisionit të posaçëm qeveritar, në përbërje të të cilit të jenë specialistë të fushave përkatëse nga ministrinë dhe institucionet qendrore për verifikimin dhe vlerësimin e gjendjes në vend.

Për dëmtime të rënda, në raste të veçanta, me arsye të motivuar, Këshilli i Ministrave ndihmon në përballimin e dëmit, në bazë të propozimit të bërë nga komisioni i posaçëm qeveritar.

6. Dëmtimet nga rrëshqitja masive e truallit

Në rastet e dëmtimeve nga rrëshqitjet masive të truallit, të kryhet studimi gjeologjik nga institucionet e specializuara të autorizuara për këtë qëllim nga Sekretariati Shtetëror për Pushtetin Lokal dhe Ministria e Punëve Publike dhe Transportit. Me anë të këtij studimi të përcaktohet paqëndrueshmëria e truallit, shtrirja që lë rrëshqitja, zhvendosjet e domosdoshme të banesave, sipas shkallës së rrezikshmërisë:

a) Banesa me rrezikshmëri të lartë, ku përfshihen banesat brenda trupit rrëshqitës.

b) Banesa me rrezikshmëri të ulët, ku përfshihen banesat jashtë trupit rrëshqitës.

Për secilin rast, ndërhyrjet e shtetit të jenë të diferencuara.

Për pikën "a", masa e ndihmës të jetë sipas pikës 4.1.

Për pikën "b", masa e ndihmës të jetë sipas pikës 4.2.

Përcaktimi i zhvendosjes së banesave bëhet brenda zonës së zhvillimit me plan rregullues të miratuar nga KRRT-ja e rrethit.

7. Dëmtimet nga përmytjet masive, zjarret dhe shpërthimet me lëndë plasëse

- Procedura që ndiqet për këto raste do të jetë sipas pikës 3 të këtij vendimi.

Masa e ndihmës falas të jetë sipas pikës 4 të këtij vendimi.

Në rastet kur shkak i djegies ose i shpërthimit nuk përcaktohet menjëherë, vetë pronari i ndërtesës duhet të paraqesë kërkesë për ekspertim në organet kompetente. Raporti i ekspertëve duhet t'i bashkëngjitet dokumentave të tjera.

8. Burimet financiare të përballimit të dëmeve

8.1. Organi i pushtetit lokal përkatës (bashkia ose komuna) ka të drejtë të përdorë për qëllimet që parashtron ky vendim, fondin rezervë të miratuar, të ardhurat, si dhe sponsorizimet dhe donacionet që mund t'i vihen në dispozicion nga donatorë të ndryshëm. Përdorimi i këtyre fondeve bëhet me vendim të Këshillit të bashkisë a komunës.

8.2. Në të gjitha rastet fondet që jep organi i pushtetit lokal ose Këshilli i Ministrave sipas këtij vendimi, administrohen nga organi i pushtetit lokal (bashkia ose komuna) përkatës. Ky organ ka detyrën e kontrollit të përdorimit të fondit vetëm qëllimin e dhënies së tij. Për këtë mund të aplikojë dhënien me këste të fondit të akorduar, duke kërkuar në vazhdimësi nga përfituesit dokumente që vërtetojnë përdorimin e këtij fondi për qëllimin e dhënies së tij.

8.3. Titullarët e organeve të pushtetit lokal, komisionet ose institucionet e tjera mbajnë përgjegjësi për zbatimin e procedurave të përmendura në këtë vendim.

8.4. Nëse organet e kontrollit në komunë, bashki, rreth, prefekturë, Sekretariatit Shtetëror për Pushtetit Lokal apo organe të tjera konstatojnë abuzime në vlerësimin e dëmeve nga komisionet, shkaktarët vihen përpara përgjegjësisë materiale dhe çështja dërgohet për ndjekje penale.

9. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Sekretariati Shtetëror për Pushtetin Lokal, si dhe komunat, bashkitë, rrethet e prefekturat.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:

- Kodi Penal (i azhornuar)
- Kodi i Procedurës Penale (i azhornuar)
- Kodi Civil (i azhornuar)
- Përmbledhje të legjislacionit në fushën e transporteve (Kodi Rrugor dhe ligji për transportet)(e azhornuar)
- Kodi Zgjedhor (I azhornuar)

U dorëzua për shtyp më 9.9.2002
Doli nga shtypi më 11.9.2002

Tirazhi: 4250 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendës së Publikimeve Zyrtare.
Tiranë, 2002

Çmimi: 150 lekë

